



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
KUVENDI  
*KËSHILLI PËR RREGULLOREN, MANDATET DHE IMUNITETIN*

Dokument parlamentar  
Tiranë, më 10.04.2024

RAPORT  
I ANËTARËVE TË SHUMICËS PARLAMENTARE MBI  
MOCIONIN NË LIDHJE ME PAPAJTUESHMËRINË E MANDATIT TË DEPUTETES  
OLTA XHAÇKA

## I. HYRJE

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në bazë të nenit 13 dhe 119/1 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi dhe vlerësoi mocionin në lidhje me papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacca, referuar Raportit të Këshillit të Legjislacionit datë 07.07.2023 në përputhje me gjetjet nga vendimet nr.1, datë 23.1.2023 dhe nr.2, datë 23.1.2023 të Gjykatës Kushtetuese, (në vijim referuar si vendimi nr.1/2023 dhe vendimi nr.2/2023).

Këshilli shqyrtoi çështjen në mbledhjen e datës 08.04.2024 dhe i paraqitet seancës plenare ky raport i anëtarëve të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

## II. BAZA KUSHTETUESE DHE LIGJORE

### Neni 70 i Kushtetutës

1. Deputetët për a ësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.
2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përve asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.
3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari itimprurëse ë uron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të itojnë pasuri të këtyre.
4. Për do shkelje të paragra fit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e ëshjtjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.

### Neni 131 i Kushtetutës

1. Gjykata Kushtetuese vendos për: ..... e) çështjet që lidhen me zgjedhshmërinë dhe papajtueshmëritë në ushtrimin e unksioneve të Presidentit të Republikës, të deputetëve, të unksionarëve të organeve të parashikuara në Kushtetutë, si dhe me veri ikimin e gjedhjes së tyre.

### Neni 132 i Kushtetutës

1. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë për undimtare dhe të detyrueshme për atim.
2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese hyjnë në fuqi në ditën e publikimit në Fletoren Zyrtare. Gjykata Kushtetuese mund të urdhërojë zbatimin e vendimit të saj, me të cilin ka shprehur aktin, të cilin e ilet në një datë tjetër.
3. Mendimi i pakicës mund të kërket shprehjen e vendimit për undimtar.

### Neni 134 i Kushtetutës

1. Gjykata Kushtetuese vilet në lëvizje me kërkesë të: ..... c) jo më pak se një të pestës së deputetëve;

### Neni 119/1 i Rregullores së Kuvendit

1. Kur i imet e përcaktuara në këtë nen illojnë ditën e deputeti shpallet i zgjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose, në rast ankimi, nga gjykata kompetente. Deputeti merr të gjitha masat për të shmangur do situatë papajtueshmërie ose konflikti i interesit, që mund të lindë në momentin e fillimit të mandatit parlamentar dhe gjatë gjithë kohës që ai va hdon. Deputeti ndërmerr veprimet konkrete jo më vonë se momenti i shpalljes së rezultatit për undimtar të zgjedhjeve, kohë në të cilën mundësohet siguria dhe integriteti i deputeti për të ardhurat e tij inanciare.
2. Për do shkelje të kësaj neni, është dërgohet pa vonesë në Gjykatën Kushtetuese. Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, veri ikon nëse mocioni i paraftur plotëson kërkesat juridiko formale, si janë numri i anëtarëve nënkthues, ekstenca e dokumentacionit dhe provave që mështesin mocionin e paraftur, veri ikon momentin e marrjes së mandatit nga deputeti, veri ikon nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdeset për respektimin e procedurës parlamentare për votimin e mocionit në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e Rregullores së tij.
3. Kuvendi nuk vë në diskutim mocionin e paraftur dhe nuk ia nënshton atë deatit parlamentar, pasi nuk i hyn themelit të është për të vlerësuar nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij.
4. Vlerësimi i meritës së është, nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur pikën 3, të nenit 70, të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një është që i përket ekskluzivisht Gjykatës Kushtetuese.

### Neni 87 i Rregullores së Kuvendit

1. Kryetari i Kuvendit i përcjell Këshillit për Legjislacionin vendimet e Gjykatës Kushtetuese për a vlerësimin e kushtetutshmërisë së legjislacionit që ka nismëtar deputetin/deputetët

interpretimin për undimtar të Kushtetutës

- c gjidhjen e mosmarrëveshjeve të kompetencës kur Kuvendi është palë shkarkimin e funksionarëve kushtetues, të cilët gjidhen nga Kuvendi
- d rastet kur kërkesa në Gjykatë Kushtetuese është para itur nga jo më pak se 1/ e deputetëve.

2. Vendimet e Gjykatës Kushtetuese, të kanë e ekt në legjislacion, merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin rrenda 30 ditëve pas miratimit të tyre në Fletoren Zyrtare.

3. Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, e ektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, për të shqyrtjet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni. Këshilli harton një raport dhe ia paraqet atë Kryetarit të Kuvendit.

4. Raporti i Këshillit, kur çmohet e nevojshme, mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.

. Kur nevojitet marrja e nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion, Këshilli i paraqet rekomandimet e nevojshme komisionit përgjegjës dhe nismëtarit, ose ndërmerr vetë nismën ligjvënëse.

Ligji nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, i ndryshuar.

## Neni 66

...2. Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose të një të pestës së deputetëve...

## III. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Në datën 20.06.2022, 14 deputetë në bazë të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës së Shqipërisë, i janë drejtuar Kuvendit me mocion “Për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes së Kuvendit, Olta Xhaçka”, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës (mocioni i parë).

2. Me shkresën nr. 2402, datë 01.07.2022, një grup tjetër, i përbërë nga 15 deputetë po të pakicës parlamentare, kanë depozituar në Kuvend një kërkesë për mocion për ndjekjen e procedurës parlamentare për konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka, duke pretenduar ushtrimin nga kjo e fundit të funksionit të deputetes në kundërshtim me nenin 70, pikat 2 dhe 3, të Kushtetutës (mocioni i dytë). Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin bashkoi kërkesat dhe kreu shqyrtimin e tyre në të njëjtën procedurë.

3. Në raportin e saj pakica parlamentare ka konkluduar se mocionet plotësonin kriteret kushtetuese dhe Kuvendi kishte detyrimin për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, për sa kohë kërkesat lidheshin me kryerjen e veprimtarive fitimprurëse që buronin nga pasuria e shtetit.

4. Shumica parlamentare në raportin e saj ka konkluduar se nga aktet e depozituara prej kërkuesve të të dy mocioneve nuk rezultonte që për deputeten Olta Xhaçka dhe bashkëshortin e saj të plotësoheshin kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës (kryerja e

veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit dhe e pushtetit vendor dhe përfitimi i pasurive të këtyre të fundit) për vënien në lëvizje të Gjykatës sipas përcaktimeve të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës. Në kushtet kur ndërmjet përfaqësuesve të pakicës parlamentare dhe asaj të shumicës nuk është rënë dakord për dërgimin e çështjes në Gjykatë, raportet i kanë kaluar për shqyrtim seancës plenare të Kuvendit.

5. Me vendimin nr. 83, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur: “Mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” (vendimi nr. 83/2022), ndërsa me vendimin nr. 84, datë 17.11.2022, Kuvendi ka vendosur: “Miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin me objekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” (vendimi nr. 84/2022).

6. Duke mos qenë dakort me këto vendimmarrje, në datën 18.11.2022, një grup tjetër prej 28 deputetësh të Kuvendit, në cilësinë e subjektit kushtetues jo më pak se një e pesta e deputetëve, ka vënë në lëvizje Gjykatën për shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të vendimeve nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si dhe konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes Olta Xhaçka (çështja objekt shqyrtimi). Në lidhje me këtë kërkesë, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese në datën 07.12.2022 vendosi kalimin e kërkesës për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve dhe kjo e fundit në datën 16.12.2022 vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare publike.

7. Gjithashtu, me kërkesën e datës 18.11.2022, një grup prej 14 deputetësh të Kuvendit, një e dhjeta e deputetëve, në kuptim të pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës, i është drejtuar Gjykatës me kërkesë për zgjidhjen e mosmarrëveshjes së kompetencës të krijuar mes tij dhe Kuvendit, të shkaktuar nga vendimmarrjet nr. 83/2022 dhe nr. 84/2022 të Kuvendit, si dhe shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën, të këtyre akteve, të cilat janë bërë shkak për lindjen e këtij konflikti me natyrë kushtetuese. Për këtë kërkesë, në datën 05.12.2022 Kolegji i Gjykatës Kushtetuese vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim paraprak në Mbledhjen e Gjyqtarëve. Mbledhja e Gjyqtarëve në datën 16.12.2022 vendosi kalimin e të dyja çështjeve për shqyrtim në seancë plenare publike, që u caktua në datë 18.1.2023.

8. Gjykata Kushtetuese për kërkesën e 14 deputetëve të Kuvendit të Sh ipërisë jo më pak se 1/10 e deputetëve), me vendimin nr.1, datë 23.1.2023, ka vendosur:

**1. Pranimin e kërkesës.**

**2. Zgjidhjen e kon liktit/mosmarrëveshjes së kompetencës ndërmjet Kuvendit të Sh ipërisë dhe su jektit kushtetues në kon likt, jo më pak se 1/10 ta e deputetëve.**

**3. Sh u i imin e vendimeve nr. 83, datë 17.11.2022 “Për mosmiratimin e raportit të pakicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me o jekt konstatimin e pavlefshmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” dhe nr. 84, datë 17.11.2022 “Për miratimin e raportit të shumicës parlamentare në Këshillin për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, me o jekt konstatimin e pavle shmërisë dhe mbarimit të mandatit të deputetes Olta Xhaçka” të Kuvendit të Shqipërisë, si të papajtueshme me Kushtetutën e Repu likës së Sh ipërisë.**

**Ky vendim është për undimtar dhe hyn në u i ditën e otimit në Fletoren Zyrtare.**

9. Gjykata ka arsyetuar, ndër të tjera, se Kuvendi nuk mund të vlerësojë në themel nëse deputetja në fjalë, përmes bashkëshortit të saj, ka kryer veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe nëse ka fituar pasuri të këtyre, si dhe nëse veprimet/mosveprimet e deputetes, përmes bashkëshortit të saj, përbëjnë shkelje të pikës 2 ose të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Me fjalë të tjera, sipas Gjykatës, çështja e vlerësimit të papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes, e cila nëpërmjet bashkëshortit mund të ketë ushtruar veprimtari fitimprurëse që burojnë nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe të ketë fituar pasuri të këtyre, referuar fakteve, nuk i takon vlerësimit të Kuvendit, por vlerësimit të kësaj Gjykate, pasi ato (faktet) kërkojnë shqyrtimin në themel, në mënyrë që të mund të përcaktohet nëse duhet të klasifikohen në parashikimet e nenit 70, pika 2 ose nenit 70, pika 3, të Kushtetutës.

10. Gjithashtu, Gjykata arsyeton se: ...55 **Gjykata rithekson se në atim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të para esë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe m arimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e ështëjes, për sa kohë ë pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të sh yrtojë kërkesa të tilla.**

6. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret **Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuarit dhe të dërgonte ështëjen për sh yrtim në këtë Gjykatë, në mënyrë ë aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes *Olta Xhaçka t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u veri ikua ndonjë pengesë juridiko ormale ë mocioni të pengohet nga Kuvendi.***

11. Ndërsa në lidhje me kërkesën e 1/5 të deputetëve me vendimin e saj nr.2, datë 23.1.2023, Gjykata Kushtetuese vendosi:

**1.Pushimin e gjykimit të ështëjes.**

**Ky vendim është për undimtar dhe hyn në u i ditën e otimit në Fletoren Zyrtare.**

Në këtë vendim, Gjykata arsyetoi, ndër të tjera se: ....**Gjykata vlerëson se nuk ka juridiksion për të sh yrtuar kërkimet në lidhje me shkeljen e ndalimeve të nenit 70, pika 2 të Kushtetutës dhe gjykimi duhet të pushohet.**

....**Ndërsa për kërkimet për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Gjykata konstaton se ai ka marrë përgjigje në vendimin e saj nr. 1/2023. Si më lart u parashtrua, në këtë vendim, në koherencë me jurisprudencën e saj, Gjykata ka ritheksuar se në atim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të para esë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe m arimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me qëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t'u shprehur për themelin e ështëjes, për sa kohë ë pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të sh yrtojë kërkesa të tilla shih paragra in të vendimit . Ndërkohë, pika 4 e nenit 70 të Kushtetutës përcakton se për do shkelje të paragra it 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e ështëjes në Gjykatë, e cila konstaton papajtueshmërinë. Pra, konstatimi i papajtueshmërisë dhe m arimit të mandatit të deputetit për shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës është një ështëje ë i përket juridiksionit të Gjykatës, juridiksion ky ë aktivi ohet vetëm me kërkesë të Kuvendit. Për sa kohë ë ky i undit nuk ka vendosur për dërgimin e ështëjes në Gjykatë, juridiksioni i saj për konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit të deputetes *Olta Xha* ka për shkelje të ndalimeve sipas pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, nuk është aktivi uar.**



12. Këshilli i Legjislacionit i mori në shqyrtim këto vendime bazuar në nenin 87, pika 1, shkronja “c”, të Rregullores së Kuvendit. Këshilli i Legjislacionit në zbatim të nenit 87 të Rregullores së Kuvendit, menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare, mori në shqyrtim dhe analizoi vendimet nr 1/2023; nr.2/2023 të Gjykatës Kushtetuese me qëllim zbatimin e tyre. Për shkak të nevojës së qartësisimit të çështjeve me synim zbatimin e këtyre vendimeve, çështje që lindnin nga vetë arsyetimi i tyre, detyrimi për të respektuar konsistencën me praktikën e mëparshme të Gjykatës Kushtetuese si dhe evoluiimin e kuadrit kushtetues e ligjor të zbatueshëm për shqyrtimin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, Këshilli i Legjislacionit kreu një proces parlamentar shterues. Këshilli, ndër të tjera, gjatë shqyrtimit caktoi ekspert konstitucionalist, i cili u dha përgjigje pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e tij, përfaqësues të shumicës dhe pakicës parlamentare.

13. Në përfundim të shqyrtimit, Këshilli për Legjislacionin i njoftoi raportin këshillimor Kryetares së Kuvendit, ku u përfshi mendimi i pakicës dhe shumicës parlamentare. Pakica mbajti qëndrimin që çështja t’i dërgohej seancës plenare për të vendosur dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese; ndërsa shumica vlerësoi që çështja përpara se të kalonte në seancë plenare duhej shqyrtuar nga Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin.

14. Shumica në Këshillin e Legjislacionit vlerësoi se duke pasur në konsideratë kompetencat e listuara nga neni 13 i Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin duhet që të vlerësojë kërkesën për mocion në përputhje me gjetjet nga vendimet e saj nr.1, datë 23.1.2023 dhe nr.2, datë 23.1.2023 të Gjykatës Kushtetuese.

Respektimi i kërkesave të Rregullores së Kuvendit, duke i kërkuar Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin që të bëjë vlerësimin e mësipërm, është kërkesë e nenit 78, pika 2 e Kushtetutës, sipas të cilës: **M ledhjet e deputetëve ë m ahen pa u thirrur sipas rregullores, nuk sjellin asnjë pasojë.**

Për këtë arsye, nëse procedohej me dërgimin e kërkesës për mocion drejtëpërdrejtë në seancë plenare, pa respektuar kërkesat e Rregullores së Kuvendit, vecanërisht ato të nenit 13 dhe nenit 119/1, bën që mbledhja e Kuvendit që do të duhej të vendoste për dërgimin e çështjes së pajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve nga deputetja Olta Xhaçka, në Gjykatën Kushtetuese, sic e kërkonin përfaqësuesit e pakicës parlamentare në Këshillin e Legjislacionit, të mos sillte asnjë pasojë.

15. Kryetarja e Kuvendit u njoh me raportin e Këshillit të Legjislacionit në datën 23.07.2023, në përfundim të sesionit parlamentar. Pas konsultimit të raportit sipas procedurave të Kuvendit, Kryetarja referuar nenit 70, nenit 78, pika 2 të Kushtetutës, dhe neneve 13, 119/1, 116 të Rregullores vlerësoi të thërresë mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin. Për shkak të situatës së krijuar në Kuvend prej bllokimit të punimeve parlamentare nga një pjesë e deputetëve të opozitës, Këshilli e kishte të pamundur të mblidhej në ato kushte anormaliteti të veprimtarisë parlamentare për disa muaj. Pas kthimit në normalitet të punimeve të Kuvendit, Kryetarja njoftoi në Konferencën e Kryetarëve të datës 03.04.2024 se mbledhja e Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit do të thirrej menjëherë dhe me shkresën datë 3.4.2024 u njoftua zhvillimi i mbledhjes në datë 8 Prill 2024.

Në mbledhjen e Këshillit të Mandateve pas diskutimeve u vendos që çështja të bëhej pjesë e rendit të ditës së seancës më të parë. Pakica dhe shumica parlamentare teksa nuk u pajtuan për një raport të përbashkët, i paraqesin seancës plenare raporte të vecanta.

#### IV. ARSYETIMI

16. Veprimtaria parlamentare që nga shqyrtimi në Këshillin e Legjislacionit dhe mandej në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese nr.1/2023 dhe nr.2/2023 ushtrohet në zbatim të detyrimit kushtetues parashikuar në nenin 132 të Kushtetutës se vendimet e Gjykatës Kushtetuese janë të detyrueshme për zbatim. Këshilli për Rregulloren e merr çështjen në shqyrtim referuar nenit 70 të Kushtetutës, nenit 13 dhe 119/1 të Rregullores së Kuvendit si dhe në vijim të Raportit të Këshillit të Legjislacionit datë 07.07.2023.

17. Ky Këshill i ka shqyrtuar më parë dy mocionet e grupimeve të deputetëve të opozitës për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaska, dhe shumica parlamentare ka arritur në konkluzionin se nga aktet e depozituara prej kërkuesve të të dy mocioneve, (akte këto që janë të njëjta dhe në procedurën aktuale), nuk rezulton që për deputeten Olta Xhaska të plotësoheshin kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës (kryerja e veprimtarisë fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit dhe e pushtetit vendor dhe përfitimi i pasurive të këtyre të fundit) për vënien në lëvizje të Gjykatës sipas përcaktimeve të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës.

18. Në konkluzionin e mësipërm, shumica arriti bazuar në parashikimet e nenit 70 të Kushtetutës, ku shprehimisht thuhet:

- 1. Deputetët për a ësojnë popullin dhe nuk lidhen me asnjë mandat detyrues.**
- 2. Deputetët nuk mund të ushtrojnë njëkohësisht asnjë detyrë tjetër shtetërore, përveç asaj të anëtarit të Këshillit të Ministrave. Rastet e tjera të papajtueshmërisë caktohen me ligj.**
- 3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor dhe as të itojnë pasuri të këtyre.**
- 4. Për do shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të kryetarit të Kuvendit ose të një së dhjetës së anëtarëve të tij, Kuvendi vendos për dërgimin e ështëjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë.**

19. Neni 70 i Kushtetutës është trajtuar nga Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj:

- Vendimi nr.29, datë 30.6.2011 që trajton momentin e lindjes së papajtueshmërisë dhe konfliktit të interesit me detyrën e deputetit; organit që do të konstatojë marrëdhënien e konfliktit të interesit në kuptim të nenit 70, pika 3 të Kushtetutës; rrezikut për lindjen e konfliktit të kompetencave midis Kuvendit dhe ILDKP-së kur kjo e fundit ka filluar hetimin paraprakisht.

- Vendimi nr.44, datë 07.10.2011, ku Gjykata Kushtetuese, në paragrafët nr. 6-16 të vendimit, bën një analizë të gjatë nëse vendimmarrja e Kuvendit për ta çuar çështjen në Gjykatën Kushtetuese ishte marrë apo jo në përputhje me Kushtetutën dhe me Rregulloren e Kuvendit. Më pas Gjykata Kushtetuese shprehet për momentin e fillimit dhe mbarimit të mandatit të deputetit (paragrafët 17-34) dhe më pas elaboron konceptin e pajtueshmërisë së mandatit të deputetit sipas nenit 70, pika 3 e Kushtetutës, (paragrafët nr. 35-39). Në vijim Gjykata Kushtetuese analizon rastin konkret të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit Ilir Beqja (paragrafët 40-42).

- Vendimi nr.7, datë 24.02.2016, ku Gjykata Kushtetuese, bëri interpretimin përfundimtar të nenit 70 të Kushtetutës dhe ndër të tjera, mbajti qëndrimin se:

32. ... Gjkata arrin në përfundimin se për çdo shkelje të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, kur kërkohet konstatimi i papajtueshmërisë me mandatin e deputetit, Kuvendi është i detyruar ta dërgojë është në Gjykatën Kushtetuese, e cila është organi i vetëm e ka kompetencën ta sh yrtojë në themel është. Në raste të tilla hapësira e vlerësimit të Kuvendit lidhet vetëm me veri ikimin e kriterëve juridiko ormale, duke respektuar procedurat parlamentare të parashikuara në Rregulloren e këtij organi.

Nga kjo vendimmarrje e Gjykatës Kushtetuese rezulton se grupimi prej jo më pak se 1/5 e deputetëve, subjekt i parashikuar nga Kushtetuta, në nenin 134, pika 1, gërma “c”, nuk legjitimohej që t’i drejtohej Gjykatës Kushtetuese për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit. Gjithashtu, ndryshe nga sa ishte konceptuar nga hartuesit e Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese konkludoi se roli i Kuvendit në këto raste ishte vetëm verifikimi i kriterëve formale të kërkesës për mocion të paraqitur dhe jo vlerësimi në themel i kësaj kërkesë. Në këtë rast, Kuvendi duhej që t’i dërgonte është Gjykatës Kushtetuese.

20. Mbas, kësaj vendimmarrje të Gjykatës Kushtetuese sipas vendimit nr. 7/2016, Kuvendi, duke njohur fuqinë detyruese të vendimeve të këtij organi, vijoi që të dërgojë në Gjykatën Kushtetuese, mocionet për papajtueshmërinë e deputetëve në ushtrimin e funksioneve nga ana e tyre. Kështu, u dërgua menjëherë në Gjykatën Kushtetuese, rasti i deputetit Koço Kokëdhima, ku Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.32, datë 3.6.2016, vendosi konstatimin e papajtueshmërisë së mandatit.

Ajo që është për t’u theksuar është se si në rastin e vendimit nr.32, datë 3.6.2016, ashtu edhe në rastin e vendimit nr. 44, datë 7.1.2011 të Gjykatës Kushtetuese, të dy deputetët, kishin kryer vetë veprime, të cilat u konstatuan se binin në kundërshtim me nenin 70, pika 3 e Kushtetutës.

21. Kuvendi, vijoi në mënyrë të menjëhershme të dërgonte çdo mocion që paraqitej ndaj deputetëve, në bazë të nenit 70 të Kushtetutës, pa bërë diferencime midis rasteve të parashikuara prej tij (pika 2 apo pika 3 e nenit). Kështu nga Kuvendi u dërguan dhe dy kërkesa të tjera, për deputetët Valentina Leskaj dhe Rakip Suli. Këto raste ishin të ndryshme nga dy rastet e para për shkak se nuk pretendohesh që veprimet të ishin kryer nga vetë deputetët, por nga persona të lidhur me ta.

22. Kështu, për rastin e deputetes Valentina Leskaj, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese me vendimin nr. 93, datë 17.05.2016 arsyetoi se:

*“ ... 14. Bazuar në paragrafin 4 të nenin 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencës kushtetuese, Kolegji vëren se Gjykata ka juridiksion për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkeljet e paragrafit 3 të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutë ërësi ka parashikuar vënien në lëvi je të Gjykatës Kushtetuese, sipas paragrafit 4 të nenit 70, e cila në raste të tilla është organi e ka kompetencën për të sh yrtuar në themel është. Për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë sipas paragrafit 2 të nenit 70 të Kushtetutës apo ligjeve tek të cilat ai referon, Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre.*



**1 . Për sa më sipër, Kolegji vlerëson se në rastin konkret nuk plotësohen kushtet për vënien në lëvi je të Gjykatës, në kuptim të përm ajtjes së nenit 70/4 të Kushtetutës, për rrjedhojë sh yrtimi i kërkesës së para itur nga Kuvendi nuk hyn në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese.”**

23. Ndërsa, përsa i përket kërkesës për deputetin Rakip Suli, duke qenë se çështja kaloi për gjykim, Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj nr.72, datë 7.12.2016, mbajti qëndrimin se:

**1 . Ba uar në paragra in 4, të nenit 70 të Kushtetutës dhe jurisprudencën kushtetuese, Gjykata ka juridiksion për rastet e vlerësimit të papajtueshmërisë me mandatin për shkelje të paragrafit 3, të nenit 70, kur vetë deputeti me veprimet e tij shkel ndalimin kushtetues të parashikuar në këtë dispozitë, pra nëse kryen veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, ose fiton pasuri të këtyre. Vetëm në lidhje me këtë ndalim kushtetutë ërësi ka parashikuar vënien në lëvi je të Gjykatës Kushtetuese, sipas paragra it 4 të nenit 70, e cila në raste të tilla është organi ë ka kompetencën për të sh yrtuar në themel ështëjten. Për sa u takon rasteve të tjera të papajtueshmërisë, sipas paragrafit 2, të nenit 70 të Kushtetutës apo ligjeve te të cilat ai referon, Gjykata Kushtetuese nuk ka juridiksion për shqyrtimin e tyre.**

...  
**18. Në konklusion, Gjykata vlerëson se konstatimi i papajtueshmërisë së mandatit të deputetit është në juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese vetëm në rastet e parashikuara nga neni 70/3 i Kushtetutës, kurse për të gjitha rastet e tjera legjislatori ka parashikuar vetë Kuvendin si institucionin i cili vendos për he jen ose jo të mandatit të deputetit.**

24. Nga sa më sipër, në të dyja rastet që përshkruhen në paragrafin 22 dhe 23 të këtij raporti, Gjykata Kushtetuese, megjithëse e venë në lëvizje nga ana e Kuvendit, mbi bazën e kërkesës së një grupi deputetësh (jo më pak se një e dhjeta e tyre), vendosi të mos e marrë në shqyrtim një kërkesë të tillë, duke specifikuar që kjo mbetet një çështje e Kuvendit të Shqipërisë për t'u vlerësuar në këto raste.

25. Nga jurisprudenca e mësipërme e Gjykatës Kushtetuese, që nga viti 2011 deri në vitin 2016, dalin këto konkluzione:

- a) Kushtetuta parashikon dy raste papajtueshmërie të veprimtarisë së deputetit, ajo e parashikuar nga pika 2 e nenit 70 dhe ajo e parashikuar nga pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës.
- b) Kuvendi është organi që shqyrton kërkesat që paraqiten për papajtueshmërinë e mandatit të deputetëve. Në rastin e pikës 2 të nenit 70 të Kushtetutës, kjo papajtueshmëri vlerësohet nga vetë Kuvendi, si nga ana formale ashtu edhe për bazueshmërinë në themel. Në rastin e pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës, Kuvendi vlerëson vetëm anën formale të kërkesës dhe duhet t'ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese.
- c) Kërkesa në rastin e pikës 3 të nenit 70 nuk i nënshtrohet asnjë debati parlamentar.
- d) Gjykata Kushtetuese vlerëson vetëm rastet e parashikuara nga pika 3 e nenit 70 të Kushtetutës.
- dh) Pavarësisht se Kushtetuta parashikonte se gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me vendim të Kuvendit (neni 70, pika 4 e Kushtetutës) apo me kërkesë të 1/5 të deputetëve (neni 134, pika 1, gërma „c“ i Kushtetutës në atë kohë) sipas vendimarrjes së Gjykatës Kushtetuese ne vendimin nr. 7/2016, grupimi prej jo më pak se 1/5 e deputetëve, nuk do të legjitimohej që t'i drejtohej Gjykatës Kushtetuese në këto raste.

e) Vendimet e Gjykatës Kushtetuese për rastet e deputetëve Valentina Leskaj dhe Rakip Suli shpjeguar në paragrafët 22 dhe 23 të këtij raporti, vendime të dhëna pas vendimit nr.7/2016 të Gjykatës Kushtetuese vendosën disa standarte për trajtimin e kërkesave të papajtueshmërisë së mandatit të deputetit duke diferencuar trajtimin e rasteve sipas pikës 2 dhe 3 të nenit 70 të Kushtetutës.

f). Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit ashtu si dhe Gjykata Kushtetuese nuk krijojnë norma kushtetuese. Në rastet e mëparshme të shqyrtuara nga Këshilli për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit dhe në jurisprudencën ndër vite të Gjykatës Kushtetuese, ky parim ka udhëhequr trajtimin e të gjitha çështjeve dhe nuk ka patur asnjë rast për devijime dhe cënim të parimit të ndarjes së pushteteve.

26. Pas vendimit nr. 7 të vitit 2016 të Gjykatës Kushtetuese, Kushtetuta ndryshoi në kuadër të Reformës në Drejtësi dhe përsëri u riafirmua edhe një herë e drejta e 1/5-ës së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, duke materializuar vullnetin e Kushtetutbërësit për legjitimimin si kërkuar të 1/5 së deputetëve në Gjykatën Kushtetuese për rastet e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit (neni 131, pika 1, gërma e) dhe neni 134, pika 1, gërma c) të Kushtetutës nuk u prekën).

27. Gjithashtu, vullneti i Kushtetutbërësit për legjitimimin e 1/5 së deputetëve për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese për rastet e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit, u reflektua dhe me miratimin e Ligjit nr.99/2016 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, ku ndër të tjera, neni 57, duke ndryshuar tërësisht nenit 66, përcaktoi se:

- 1. Për shqyrtimin e gjedhshmërisë së deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvi je me kërkesë të Presidentit të Repu likës, të jo më pak se një të pestës së deputetëve të Kuvendit ose të partive politike.**
- 2. Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e funksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvizje me kërkesë të Kuvendit ose të një të pestës së deputetëve.**
- 3. Gjykata Kushtetuese veri ikon, sipas Kushtetutës, gjedhjen e deputetëve, me kërkesë të partisë politike ose të kandidatit të pavarur për deputet.**

Në këtë rast, me këtë ndryshim, Kuvendi, duke ruajtur leximin e tij të Kushtetutës, ka shtuar në ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, (miratuar me shumicë të cilësuar prej 3/5), një tjetër subjekt kërkuar për këto çështje (papajtueshmërinë e mandatit të deputetit), që mund të vërë në lëvizje gjykimin kushtetues. Ky subjekt kërkuar është 1/5 e deputetëve të Kuvendit.

28. Me tej, Kuvendi me vendimin e tij nr. 85/2019 ka miratuar shtimin e nenit 119/1 në Rregulloren e Kuvendit, dispozitë e cila parashikon se:

- 1. Ku i imet e përcaktuara në këtë nen illojnë ditën ë deputeti shpallet i gjedhur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve ose, në rast ankimi, nga gjykata kompetente. Deputeti merr të gjitha masat për të shmangur do situatë papajtueshmërie ose kon likti interesi, ë mund të lindë në momentin e illimit të mandatit parlamentar dhe gjatë gjithë kohës ë ai va hdon. Deputeti ndërmerr veprimet konkrete jo më vonë se momenti i shpalljes së re ultatit për undimtar të gjedhjeve, kohë në të cilën mundësohet siguria dhe artësia te deputeti për të ardhurat e tij inanciare.**

2. Për do shkelje të ku i imeve të këtij neni, është dërgohet pa vonesë në Gjykatën Kushtetuese. Kuvendi, nëpërmjet Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetet, veri ikon nëse mocioni i para itur plotëson kërkesat juridiko ormale, si janë numri i anëtarëve nënshkrues, ek istenca e dokumentacionit dhe provave ë m ështëin mocionin e para itur, veri ikon momentin e marrjes së mandatit nga deputeti, veri ikon nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvi je të Gjykatës Kushtetuese, si dhe kujdeset për respektimin e procedurës parlamentare për votimin e mocionit në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e Rregullores së tij.

3. Kuvendi nuk vë në diskutim mocionin e para itur dhe nuk ia nënshtron atë de atit parlamentar, pasi nuk i hyn themelit të ështëjes për të vlerësuar nëse veprimet konkrete të pretenduara të kryera nga deputeti janë të papajtueshme me mandatin e tij.

4. Vlerësimi i meritës së ështëjes, nëse me veprimet e tij deputeti ka shkelur pikën 3, të nenit 70, të Kushtetutës, me pasojë konstatimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e mandatit, është një ështëje ë i përket eksklu ivisht Gjykatës Kushtetuese.

29. Qëllimi i këtij parashikimi në Rregulloren e Kuvendit, ishte që të përputhte rregulloren me jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, ndër të tjera, sa i takon vlerësimin të mocionit në një vështrim të parë, (pa i hyrë thelbit të ështëjes), nëse janë kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvi je të Gjykatës Kushtetuese.

30. Nisur nga formulimi kushtetues, i nenit 70 të Kushtetutës, nga evoulimi i jurisprudencës së Gjykatës Kushtetuese, si edhe nga parashikimet kushtetuese, ligjore dhe të Rregullores së Kuvendit, duhet theksuar se investimi i Kuvendit për të dërguar një ështëje në Gjykatën Kushtetuese, që përfshihet brenda fushëveprimit të nenit 70, pika 2 e Kushtetutës, por që Gjykata Kushtetuese, nuk kishte pranuar që ta shqyrtonte (vendimi i Kolegjit nr.32/2016 dhe vendimit i Gjykatës Kushtetuese nr.72/2016), nuk dukej më e arsyeshme. Pra, në këtë kontekst, Kuvendi do të duhej që të vlerësonte vetë këto kërkesa, sipas konkluzioneve që kishte dhënë vetë Gjykata Kushtetuese. Pikërisht kjo jurisprudencë e Gjykatës Kushtetuese, përveç kuadrin të ri kushtetues dhe ligjor, është mbajtur parasësh dhe në vendimarrjet e Kuvendit në vendimet nr.83/2022 dhe nr.84/2022, shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese me vendimin nr.1/2023.

31. Shumica në Këshillin e Mandateve, duke iu referuar evoluimit të jurisprudencës Kushtetuese, shtratit kushtetues dhe ligjor, ndryshimeve në Rregulloren e Kuvendit për trajtimin e rasteve të papajtueshmërisë miratuar pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese n.7/2016, vlerësoi të verifikonte sipas nenit 119/1 të Rregullores së Kuvendit nëse mocionet e paraqitura për papajtueshmërinë e deputetes Olta Xhaka i plotësonin kërkesat juridiko-formale, siç janë numri i anëtarëve nënshkrues, ekzistenca e dokumentacionit dhe provave që mbështesnin mocionet e paraqitura, momenti i marrjes së mandatit nga deputeti, nëse mocionet plotësonin kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese, si dhe u kujdes për respektimin e procedurës parlamentare për votimin në seancë plenare, në përputhje me parashikimet e Rregullores së Kuvendit. Shumica parlamentare arriti në konkluzionin se nuk ishin kriteret e parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës, për të dërguar ështëjen për shqyrtim në Gjykatën Kushtetuese.

32. Bazuar në kuadrin kushtetues dhe ligjor në fuqi, shumica cmoi se janë dy subjekte që vënë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit: i) subjekti i parë,

Kuvendi, me mocion të Kryetarit ose 1/10 të deputetëve (neni 70, pika 4 e Kushtetutës); ii) subjekti i dytë, grupimi i 1/5 së deputetëve sipas nenit 134, pika 1, gërma “c” të Kushtetutës. Nëse Kuvendi apo 1/5 e deputetëve dërgon çështjen në Gjykatën Kushtetuese, kjo e fundit kur e merr në shqyrtim në themel çështjen, shprehet për zgjidhjen e kërkesave që i parashtrohen.

33. Ndërkohë që Kuvendi vendosi mosdërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese duke vlerësuar se nuk plotësoheshin kriteret e nenit 70, pika 3 të Kushtetutës (**vlerësimi prima acie**), grupimi i 1/5 së deputetëve vlerësoi së legjitimohej t’i drejtohej direkt Gjykatës Kushtetuese për të kërkuar papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacka dhe paraqiti në këtë Gjykatë kërkesën përkatëse. Kjo konfirmohet dhe nga faktet që rezultuan pas vendimarrjes së Kuvendit për mosdërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese dhe konkretisht:

- 1/5 e deputetëve iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesë për pavlefshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacka për shkak të papajtueshmërisë sipas kriterëve të pikës 3 të nenit 70 të Kushtetutës.
- Gjykata Kushtetuese e shqyrtoi këtë kërkesë në Kolegj, në mbledhjen e Gjyqtarëve dhe në seancë plenare. Rezulton së kjo kërkesë është shqyrtuar në themel. Palët, kërkuarit dhe deputetja Olta Xhacka, nëpërmjet përfaqësuesve/avokatëve të tyre, kanë paraqitur pretendimet dhe kërkesat përkatëse, provat ku i mbështesnin ato, i janë përgjigjur pyetjeve të njëra tjetrës dhe të gjykatës, është ezauruar në bazë të parimit të kontradiktoritetit debati gjyqësor, janë paraqitur kërkimet përfundimtare.
- Pavarësisht ezaurimit procedural të shqyrtimit në themel, gjykata nuk ka dhënë një vendim në lidhje me themelin e çështjes, por ka disponuar me vendim për pushimin e gjykimit të çështjes, me arsyetimin që jepet në paragrafin 11 të këtij raporti.

34. Sipas kuadrit kushtetues dhe ligjor në fuqi (ndryshimeve ligjore pas vendimit nr.7/2016 të Gjykatës Kushtetuese), ishte pritshmëri legjitime në përputhje me parimin e sigurisë juridike që Gjykata, teksa mori në shqyrtim në themel kërkesën e 1/5 të deputetëve të shprehej për kërkimin nga ana substanciale e të vendoste nëse Olta Xhacka ishte apo jo para një rasti papajtueshmërie të mandatit të deputetit. Kjo, në fakt mund të kishte ndihmuar dhe në evitimin e debatit e retorikës politike, dhe jo vetëm, që ngrihet mbi opinione për zvarritje apo mungesë vullneti të Kuvendit për zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, sepse realiteti është krejt ndryshe. Çështjet në lidhje me zbatimin e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese që Kuvendi po trajton prej muajsh, nuk lidhen as me zvarritje e as me mungesë vullneti për të zbatuar detyrimet kushtetuese, por me paqartësi për situata juridike që lënë në pafuqishmëri nene kushtetuese dhe ligjore për legjitimitimin e subjekteve para Gjykatës Kushtetuese, të cilat nuk rezultojnë të jenë shfuqizuar. Dhe këto çështje nuk lidhen vetëm me një mandat deputeti, por me standarde kushtetuese, leximin e duhur të vullnetit të kushtetutëbërësit, balancat në demokraci etj.

35. Me vendimin nr.1/2023 Gjykata Kushtetuese, pavarësisht qëndrimeve në vendimet e saj nr.36/2017 dhe nr.72/2016 ka bërë një interpretim të zgjeruar të pikave 2 dhe/ose 3 të nenit 70 të Kushtetutës, duke e ndaluar Kuvendin të shqyrtojë qoftë edhe pretendimet e 1/10 së deputetëve ose të Kryetarit të Kuvendit nëse veprimet/mosveprimet e një deputeti përbëjnë shkelje të pikave 2 ose 3 të nenit 70 të Kushtetutës. Kjo do të thotë se edhe nëse 1/10 e deputetëve ose Kryetari i Kuvendit e kualifikon shkeljen e një deputeti sipas pikave 2 dhe 3 të nenit 70, sërish është Gjykata Kushtetuese ajo që do të shqyrtojë dhe vendosë për këtë kualifikim. Shumica vlerëson të nënvizojë se Kuvendi në ushtrim të kompetencave të tij kushtetuese dhe në cilësinë e organit që krijon norma

kushtetuese, është interpretuesi i parë i Kushtetutës. Në këtë kuptim është marrë vendimi i Kuvendit vitit 2022 për miratimin e raportit të shumicës parlamentare për të mos e dërguar mocionin për papajtueshmërinë e mandatit në Gjykatën Kushtetuese. Gjykata Kushtetuese është interpretuesi fundor i Kushtetutës. Për rrjedhojë Kuvendi ka detyrim të zbatojë jo vetëm një vendim të saj, por gjithë vendimet e Gjykatës Kushtetuese në harmoni të plotë si interpretuesja fundore e Kushtetutës.

Në këto kushte, Kuvendi ndodhet në një situatë pamundësie për të vepruar ndryshe, pasi i duhet të zgjedhë se cilin qëndrim të Gjykatës Kushtetuese të respektojë mes standarteve të ndryshme të vitit 2016 dhe 2023. Gjithashtu, nga ana tjetër, grupimit prej 1/5 të deputetëve, sic është sqaruar më sipër i është mohuar e drejta për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese parashikuar në Kushtetutë dhe ligjin organik të Gjykatës Kushtetuese, në dispozita që janë ende në fuqi.

36. Edhe pse janë dy vendime të Gjykatës Kushtetuese për rastin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhaka, detyrimi i Kuvendit për zbatimin tyre lidhet me vendimin nr.1/2023 (me kërkues 1/10 e deputetëve), sepse vendimi tjetër ai me nr. 2/2023 (me kërkues 1/5 e deputetëve) ka vendosur pushimin e gjykimit të çështjes. Një vendim gjykate që disponon pushim gjykimi nuk ka lëndë për ekzekutim (vendimi nr.2/2023), por sa parashtrohet më sipër ndikon në zbatimin e vendimit tjetër të Gjykatës Kushtetuese nr.1/2023 (vendimi që duhet zbatuar nga Kuvendi).

37. Në vijim të veprimtarisë së Kuvendit për të ezauruar cdo mundësi procedurale ligjore me synim zbatimin e vendimit të Gjykatës Kushtetuese nr.1/2023 sipas përcaktimeve në Kushtetutë, Rregulloren e Kuvendit dhe opinionin e Këshillit të Legjislacionit datë 07.07.2023, Këshilli i Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, duhet që të vlerësojë kërkesën për mocion në përputhje me gjetjet nga vendimet nr.1, datë 23.1.2023 dhe nr.2, datë 23.1.2023 të Gjykatës Kushtetuese. Anëtarët e shumicës parlamentare në këtë Këshill vlerësojnë se e kanë kryer një vlerësim në vështrim të parë (**prima acie**) të dy kërkesave për mocion paraqitur nga dy grupet e deputetëve të opozitës për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhaka, bazuar në nenin 119/1 të Rregullores së Kuvendit, (shih raportin e shumicës së anëtarëve të këtij Këshilli datë 19.10.2022).

38. Gjykata Kushtetuese në vendimin n.1/2023 është shprehur: ..... 56. ***Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se në rastin konkret Kuvendi duhet të kishte pranuar mocionin e kërkuesit dhe të dërgonte është për sh yrtim në këtë Gjykatë, në mënyrë e aspektet e pretenduara si papajtueshmëri të mandatit të deputetes Olta Xhaka t'i nënshtroheshin vlerësimit kushtetues, pasi gjatë gjykimit kushtetues nuk u veri ikua ndonjë pengesë juridiko ormale e mocioni të pengohet nga Kuvendi.***”.

39. Këshilli, në respektim të nenit 132 të Kushtetutës, vlerëson se nuk mund të bëjë një vlerësim të ri në vështrim të parë, përveçse t'i bëjë me dije seancës plenare të Kuvendit arsyetimin e Gjykatës Kushtetuese parashtruar në paragrafin 38 të këtij raporti për mocionin që referohet në vendimin nr.1/2023 të Gjykatës Kushtetuese, paragrafi 56.

40. Ndërkohë, Këshilli vlerëson të sqarojë se neni 119/1 i Rregullores së Kuvendit me ndryshimet e vitit 2019 (vendimi nr.85, datë 18.07.2019 i Kuvendit), bazuar në jurisprudencën kushtetuese pas vendimit nr.7/2016 të Gjykatës Kushtetuese, që parashikon, ndër të tjera, se Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin vlerëson “*nëse mocioni plotëson kriteret kushtetuese të parashikuara në pikën 3 të nenit 70 të Kushtetutës për vënien në lëvizje të Gjykatës Kushtetuese*”, është në fuqi. Këshilli nuk mund ta ushtrojë këtë kompetencë aktualisht, sa kohë Gjykata



Kushtetuese është shprehur në arsyetimin e vendimit të saj nr.1/2023 për vlerësimin e kriterëve juridike formale të mocionit (prg.56 i vendimit nr.1/2023 të Gjykatës Kushtetuese).

41. Në këto kushte, mbetet në vlerësim të seancës plenare si organi vendimarrës i Kuvendit, për të vendosur në lidhje me dërgimin e cështjes së papajtueshmërisë së mandatit të deputetes Olta Xhacker në Gjykatën Kushtetuese, referuar nenit 70, pika 4 të Kushtetutës. Neni 70, pika 4 e Kushtetutës parashikon që Kuvendi vendos për kërkesën e një të dhjetës të deputetëve apo të Kryetarit të Kuvendit në lidhje me rastin e papajtueshmërisë së mandatit të deputetit.

42. Gjykata Kushtetuese në vendimin n.1/2023 është shprehur se: “ **1. Edhe pse në përm ajtjen e pikës 4 të nenit 70 të Kushtetutës nuk është përdorur termi “është i detyruar”, kjo nuk nënkupton se vlerësimi në këtë rast është në kompetencë të Kuvendit, por se vënia në lëvi je e Gjykatës kërkon një vendimmarrje të këtij organi, e cila është produkt i seancës plenare, pas respektimit të procedurave parlamentare**”. Ndërsa në paragrafin 55 të të njëjtit vendim, Gjykata arsyeton: “ . Gjykata rithekson se në atim të nenit 70, pika 4, të Kushtetutës një e dhjeta e deputetëve të Kuvendit ka të drejtë të para esë mocion për konstatimin e papajtueshmërisë dhe m arimit të mandatit të deputetit, ndërsa vendimmarrja e Kuvendit është e domosdoshme me ëllim vënien në lëvizje të kësaj Gjykate për t’u shprehur për themelin e ështëjes, për sa kohë ë pa një vendim të këtij organi Gjykata nuk mund të shqyrtojë kërkesa të tilla”.

43. Shumica në Këshill cmon të sqarojë për kolegët deputetë se këtu është e nevojshme të kuptohet një dallim. Në dritë të arsyetimit të Gjykatës Kushtetuese parashtruar në paragrafin 41 të këtij raporti, krijohet ideja se kompetenca e Kuvendit parashikuar në nenin 70, pika 4 të Kushtetutës sipas Gjykatës Kushtetuese barazohet me parashikimet e nenit 77, pika 2 të Kushtetutës për ngritjen e komisioneve hetimore.

Neni 77, pika 2 e Kushtetutës shprehimisht thotë: “...2. **Kuvendi...., është i detyruar të caktojë komision hetimi....**”, ndërsa neni 70, pika 4 e Kushtetutës ka këtë formulim: “...**Kuvendi vendos për dërgimin e cështjes...**”.

44. Në rastin e nenit 77, pika 2 të Kushtetutës, ushtrimi i kompetencës së hetimit, ka të bëjë me funksionin ligjvënës dhe atë të kontrollit të Kuvendit dhe që ushtrohet nga vetë pakica parlamentare, e cila përcakton objektin e hetimit. Përdorimi në Kushtetutë (Neni 77, pika 2) i shprehjes “**është i detyruar**”, jo vetëm që e vendos Kuvendin në një pozicion disi të veçantë, duke i hequr të drejtën për të vlerësuar vendimmarrjen për ngritjen e komisionit hetimor, por, njëkohësisht, institucionalizon një lloj tjetër autoriteti kushtetues, që njihet si pushtet i pakicës parlamentare, gjë të cilën nuk e gjejmë tek neni 70, pika 4. Sipas rregullit të përdorimit të qendrueshëm (Presumption of Consistent Usage), një fjalë ose frazë supozohet se ka të njëjtin kuptim në të gjithë tekstin ligjor, ndërsa një ndryshim material në terma do të thotë një ndryshim në kuptim<sup>1</sup>. Bazuar në këtë rregull interpretimi, si edhe duke qenë se Kushtetuta në nenin 70, pika 4, përdor termin "vendos" për Kuvendin, ndërsa në nenin 77, pika 2, përdor termin "i detyruar", atëherë rezulton qartësisht se këto dy terma, në dy dispozita të ndryshme kanë kuptime të ndryshme juridike.

<sup>1</sup> Vendim i Gjykatës së Lartë të SHBA-së në çështjen Atlantic Cleaners & Dyers, Inc. v. United States, 286 U.S. 427, 433 (1932)". Shih edhe Antonin Scalia dhe Bryan Garner, "Reading law: The interpretation of legal texts", 2012, fq.147.

Sa sipër, duke marrë në konsideratë dhe arsyetimin në këtë raport të anëtarëve të shumicës në këtë Këshill mbi situatën që krijohet nga vendimet e Gjykatës Kushtetuese n.1/2023 dhe n.2/2023 me lënien pa fuqi (por të pashfuqizuara) të dispozitave kushtetuese dhe ligjore që legjitimojnë 1/5 e deputetëve të Kuvendit t'i drejtohen Gjykatës Kushtetuese për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, situata paraqitet dhe më e ndërlikuar.

45. Dallimi ndërmjet parashikimeve në nenin 77, pika 2 dhe nenin 70, pika 4 të Kushtetutës, ka rëndësi edhe për respektimin e një normë tjetër kushtetuese, konkretisht pika 1 e nenit 70 të Kushtetutës ku parashikohet se mandati i deputetit nuk është detyrues dhe që trajtohet në vendimin e Gjykatës Kushtetuese nr. 44, datë 07.10.2011. Gjithashtu, bazuar në opinionin e Venecias<sup>2</sup>, “qenia e lirë (jo detyruese) e mandatit të deputetit nënkupton të drejtën e deputetit të ndjekë bindjet e tij ose të saj.” Ky qëndrim është mbështetur edhe nga Gjykata Kushtetuese e Kosovës në Aktgjykimin për rastin nr. K084/18.<sup>3</sup> Si respektohet e drejta e votës së deputetit në kushtet kur neni 70, pika 1 e Kushtetutës parashikon se mandati i deputetit nuk është detyrues, sidomos kur në këtë rast kemi të bëjmë me një mocion, për të cilin edhe vetë Gjykata Kushtetuese me vendimin e saj n.1/2023, shprehet se është instrument për të vënë në lëvizje Kuvendin për të diskutuar mbi një çështje dhe në përfundim është Kuvendi ai që vendos mbi të!

46. Në përmbledhje të arsyetimit më sipër:

- Gjykata Kushtetuese me vendimin nr. 1/2023 është shprehur për mocionin e kërkuarve (1/10 të deputetëve) se .... **gjatë gjyimit kushtetues nuk u veri ikua ndonjë pengesë juridiko ormale ë mocioni të pengohet nga Kuvendi prg. 6 i vendimit ;**
- Gjykata Kushtetuese teksa ka shqyrtuar në themel kërkesën e 1/5 të deputetëve për papajtueshmërinë e mandatit të deputetes Olta Xhacka, ku kjo e fundit njësoj si kërkuar, ka marrë pjesë në gjykim përfaqësuar nga avokat dhe janë ezaruar fazat e shqyrtimit gjyqësor, ka vendosur me vendimin n.2/2023 “Pushimin e gjyimit të çështjes”.
- Gjykata Kushtetuese në vendimin nr.1/2023 vlerëson se në cdo rast kur paraqitet një mocion nga 1/10 apo Kryetari i Kuvendit, Kuvendi është i detyruar t’ia dërgojë çështjen Gjykatës Kushtetuese duke barazuar parashikimet e nenit 70, pika 4 ku thuhet “Kuvendi vendos” me ato të nenit 77, pika 2 të Kushtetutës ku thuhet “Kuvendi është i detyruar të vendosë”. Ndërkohë neni 70, pika 1 e Kushtetutës parashikon se mandati i deputetit nuk është detyrues, c’ka nënkupton të drejtën e deputetit të ndjekë bindjet e tij ose të saj.
- Gjykata Kushtetuese në arsyetimin e vendimit nr.1/2023 i referohet vendimit të saj nr.7/2016. Ndërkohë, pas këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese në vitin 2016, Kushtetutbërësi në Kushtetutë riafirmoi si subjekt që vë në lëvizje Gjykatën Kushtetuese

<sup>2</sup> Strasbourg, 16 qershor 2009 Studimi Nr. 488 / 2008 CDL-AD (2009)027 Komisioni European për Demokraci Përmes Ligjit (Komisioni i Venecias), Raporti për Mandatin Detyrues dhe Praktikën e Ngjashme, Miratuar nga Këshilli për Zgjedhje Demokratike në mbledhjen e tij të 28 (Venecia, 14 mars 2009) dhe nga Komisioni i Venecias në Sessionin e saj Plenar të 79 (Venecia, 12-13 qershor 2009 në bazë të komenteve të Z. Carlos CLOSA MONTERO (Spanjë, Anëtare)

<sup>3</sup> Shih paragrafët 117, 122 dhe 123 të Aktgjyimit nr. K084/18.

për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit, grupimin 1/5 e deputetëve, ndërsa në Ligjin nr. 8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese”, të ndryshuar, shtoi nenin 66 me përmbajtjen:....2. *Për shqyrtimin e papajtueshmërisë në ushtrimin e unksioneve të deputetëve, Gjykata Kushtetuese vihet në lëvi je me kërkesë të Kuvendit ose të një të pestës së deputetëve....* Po ashtu, Rregullorja e Kuvendit u ndryshua në vitin 2019 për të sqaruar detyrat e Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, në vijim të evoluimit të jurisprudencës kushtetuese dhe referuar kuadrit ligjor miratuar pas vendimit n. 7/2016 të Gjykatës Kushtetuese. Këto çështje nuk gjejnë trajtim në vendimet n.1/2023 dhe nr.2/2023 të Gjykatës Kushtetuese.

- Me vendimin nr.1/2023 dhe në vendimin nr.2/2023, është mohuar e drejta e 1/5 së deputetëve për t’iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese, për papajtueshmërinë e mandatit të deputetit e parashikuar në Kushtetutë e ligjin organik të Gjykatës Kushtetuesenë dispozita që mbeten pa fuqi zbatuese dhe pse ato, (dispozitat ligjore) qëndrojnë të pashfuqizuara.

**Për sa më sipër, anëtarët e shumicës parlamentare në Këshillin e Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit, vlerësojnë që çështja t’i kalojë seancës plenare për të vendosur në lidhje me dërgimin e mocionit në Gjykatën Kushtetuese sipas parashikimeve të nenit 70 të Kushtetutës.**

#### **ANETARËT E SHUMICËS PARLAMENTARE**

**Lindita NIKOLLA**

**Ermonela FELAJ    Bledi ÇUÇI    Klotilda BUSHKA    Xhemal QEFALIA**